

KOMEDIA HYJNORE- Dante Alighieri

-Vepër e Rilindjer Evropiane, që shfaq cilësi **humaniste**

-**Konteksti** në të cilin u shkrua vepra lidhet me internimin e Dantes dhe Beatricen.

-**Synimi** i veprës: Rruga e njerëzimit në kërkim të lumturisë së pamundur tokësore dhe pastrimi i shpirtit

-**Struktura** e veprës: 3 hane: Ferri, Purgatori, Parajsa që më tej ndahen në rrathë të brendshëm të secilit

-“Atdheu i njëmendtë (real) i njeriut është shpirti.”

-Vepër **alegorike**

-Edhe udhëtimi i Dantes është alegorik (nënkupton kthimin e shpirtit te Zoti (në Parajsë))

Arti i Dantes:

- Mbështetet në strukturën biblike
- Krijon strukturë harmonike
- Kompozicioni i përkryer
- Tercina

Stili dhe toni i poemës:

Ferr- Stil tragjik dhe ton i ashpër

Purgator- Stil elegjik dhe ton i përvajshëm

Parajsë- Stil lirik dhe ton i butë

S'paska idhnim ma t'madh, - m'u gjegj tue fsha, -

se me mendue për kohët e haresë

n'mjerim e vajë; mësuesi e di këtë gja.

KOMENT

Kjo tercinë është shkëputur nga kënga e pestë e Ferrit të “Komedisë Hyjnore” të Dante Alighierit. Dante, së bashku me Virgjilin, gjenden në rrethin e dytë të Ferrit, aty ku enden mëkatarët e epshit. Ndër të tjerë, Dante ka zgjedhur të bisedojë me shpirtrat e Françeska da Polentës dhe Paolo Malatestës.

Në jetën tokësore, Françeska e ka tradhtuar të shoqin e shëmtuar, Xhanshoton, me të vëllain, Paolon. Xhanshoto i vrau ata të dy dhe tashmë Dante i pyet se si ka ndodhur e gjithë ngjarja dhe kjo dashuri mes atyre të dyve. Fjala dashuri, në pyetjen e poetit, mbart me vete lumturinë, gëzimin, kohët e bukura, që i nxjerrin një psherëtimë të thellë shpirtit të mjerë e të pashpresë të Françeskës.

Në ligjërimin e saj, ajo përdor folje në mënyrën habitore, si p.sh. s’paska. Kjo, sepse hareja që vinte nga dashuria në jetën tokësore dhe shkaktonte aq shumë lumturi, çuditërisht, në Ferrin e përtejbotshëm ajo shkakton një hidhërim, i cili është aq i madh sa Françeska e vendos dhe e përcakton në shkallën sipërore. Kjo habi lind natyrshëm, pasi është e njëjta ndjenjë e të njëjtët persona, por në vende të ndryshme kanë përjetime të ndryshme.

Në kohën kur shpirtrat e Françeskës dhe të Paolos ishin të bashkuar me trupat e tyre, dashuria e tyre u ngjallte veç hare, sepse ishte një dashuri e udhëhequr nga epshi dhe jo nga ndjenjat e pastra për njëri-tjetrin. Kurse tashmë, pikërisht për shkak të dashurisë së tyre të pakontrolluar, shpirtrat e tyre janë burgosur përjetësisht në Ferr. Prandaj, Françeska thotë, se në vendin që ndodhet tashmë, kohët e haresë sjellin hidhërim.

Fraza e fundit “mësuesi e di këtë gjë” i drejtohet Virgjilit. Jo më kot quhet mësues, sepse, në këtë moment, ai është mishërimi i dijes. Pra, nëpërmjet figurës së mësuesit nënkuptohet dija, arsyeja, e vërteta. Kështu, Françeska e ka fjalën për mësimin që ka nxjerrë nga gabimi i saj:

Pasionet e çastit dhe të pamenduara mirë mund të të lumturojnë vetëm për një kohë të shkurtër. Kurse gabimet e mëdha, që vijnë nga mungesa e arsyes, të dënojnë përjetë, aq sa të vjen keq edhe t’i kujtosh ato pak momente të lumtura, që nuk do mundesh më kurrë t’i shijosh.